

**URDHËR I PËRBASHKËT**  
**Nr. 163, datë 6.6.2022**

**PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË MIKPRITJES  
DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre", ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

**URDHËROJNË:**

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit.
  2. Komiteti Sektorial TIK organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:
    - a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
    - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
    - c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e hoteleri-turizmit;
    - c) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të hoteleri-turizmit, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
    - d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
    - dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit hoteleri-turizëm, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;
    - e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore e në sektorin hoteleri-turizëm;
    - ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).
  3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar i me më shumë eksperiencë në çështjet e hoteleri-turizmit dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.
  4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave "a", "b" dhe "c", të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për përzgjedhjen e përfaqësuesit sipas gremës "dh", të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
  5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve sipas shkronjave "ç", "d", "e" dhe "ë", të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.
  6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti i Mikpritjes dhe Turizmit për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË**

**Delina Ibrahimaj**

**MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT**

**Evis Kushi**